



**ILD**

INSPEKTORI I LARTË  
I DREJTËSISË

**RAPORT VJETOR MBI ZBATIMIN E PLANIT STRATEGJIK DHE PLANIT TË  
VEPRIMIT PËR ZYRËN E INSPEKTORIT  
TË LARTË TË DREJTËSISË**

**JANAR – DHJETOR 2021**

## **PËRMBAJTJA E LËNDËS**

**KREU I – HYRJE**

**KREU II – METODOLOGJIA E PËRDORUR**

**KREU III – MONITORIMI DHE RAPORTIMI**

**KREU IV – ANALIZA E PLANIT TË VEPRIMIT GJATË NJË VITI RAPORTIMI.**

**KREU V – BUXHETI**

**KREU VI – KONKLUZIONE**

## 1. HYRJE

Me konstituimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, krahas sfidave të hasura gjatë vitit 2020, nga gjendja e shkaktuar nga pandemia globale, mungesa e theksuar e burimeve njerëzore, mungesa e mjediseve të punës, baza logjistike dhe materiale, lindi si domosdoshmëri përcaktimi i objektivave të punës për dy vitet në vijim dhe arritjen e rezultateve në bazë të objektivave, sipas qëllimeve:

- Sigurim të kontributeve për planet e veprimit për fazën tjetër të zhvillimit të reformës në drejtësi për 2021-2025 (SND II);
- Planifikim të përgjithshëm për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe për menaxhimin e performancës, dhe monitorim periodik të të dhënave periodike të marra nga strukturat përbërëse të institucionit.

Puna për Planin Strategjik dhe Planin e Veprimit filloi më një grup të vogël personash në maj të vitit 2020 dhe vazhdoi deri në fund të qershorit me një projekt fillestar. Gjatë muajve shtator-nëntor, me plotësimin e strukturës organizative për funksionet e Kabinetit, Njësisë së Ndihmës së Inspektorëve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve dhe Shërbimeve Juridike, u ripunua projekti i strategjisë duke rishikuar dhe verifikuar treguesit. Në tetor 2020, në sajë të angazhimit të përbashkët institucional u dakordësua dhe u finalizua projekt strategjia dhe plani i veprimit, të cilët në fund të muajit tetor u konsultuan sërish me të gjithë strukturat e brendshme të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shoqërinë civile, organizatat ndërkombëtare dhe institucionet qendrore.

Plani Strategjik i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është hartuar sipas kornizës së Sistemit të Planifikimit të Integruar duke zbatuar një qasje koordinimi sistematik dhe të integruar në zhvillimet e procesit të Integritimit Evropian, në kërkesat e Programit Buxhetor Afatmesëm, në programin e investimeve publike dhe atë të ndihmës së huaj.

Procesi i hartimit të strategjisë dhe planit të veprimit është realizuar duke mbajtur në konsideratë kombinimin e përparësive me mundësitë që institucioni ka në dispozicion, si dhe eliminimin e dobësive të institucionit dhe shmangien e risqeve potenciale. Metoda e përdorur për të vlerësuar riskun në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, lidhet me analizimin e faktorëve potencialë të riskut me të cilat përballlet institucioni, me ndikim të brendshëm nga proceset e punës, por edhe nga faktorë të jashtëm. Në vlerësim të riskut potencial është aplikuar analiza SWOT (Fuqitë-Dobësitë-Mundësitë-Risqet), ku janë ndërlidhur kapacitetet e brendshme dhe mangësitë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me kërkesat dhe sfidat e jashtme me të cilat mund të përballlet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Plani përputhet me objektivat afatmesme dhe afatgjata të qeverisjes, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, si dhe Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë. Një vëmendje e veçantë gjatë Hartimit të Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit, i është kushtuar sfidave me të cilat është hasur Zyra e Inspektorit të Lartë që në momentin e krijimit, duke nisur më mungesën në burime njerëzore dhe në infrastrukturë si dhe gjendjen e shkaktuar nga pandemia globale. Gjithashtu është bërë edhe një analizë rreth situatës aktuale në të cilën ndodhet institucioni dhe është dhënë një

informacion i përmbledhur në lidhje me numrin e ankesave, trajtimin e tyre dhe gjendjen aktuale të stafit. Procesi i hartimit të strategjisë dhe planit të veprimit është realizuar duke mbajtur në konsideratë kombinimin e përparësive me mundësitë që institucioni ka në dispozicion, si dhe eliminimin e dobësive të institucionit dhe shmangien e risqeve potenciale.

Metoda e përdorur për të vlerësuar riskun në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, lidhet me analizimin e faktorëve potencialë të riskut me të cilat përballet institucioni, me ndikim të brendshëm nga proceset e punës, por edhe nga faktorë të jashtëm. Në vlerësim të riskut potencial është aplikuar analiza SWOT (Fuqitë-Dobësitë-Mundësitë-Risqet), ku janë ndërlidhur kapacitetet e brendshme dhe mangësitë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me kërkesat dhe sfidat e jashtme me të cilat mund të përballet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Brenda një muaji nga miratimi i planit strategjik dhe planit të veprimit u përcaktua një sistem monitorimi efektiv, i unifikuar dhe sistematik, për raportim nga të gjitha njësitë organizative të përfshira në zbatimin e planit të veprimit, i cili ofron informacion periodik në lidhje me ecurinë e zbatimit të aktiviteteve.

Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit 2-vjeçar, është miratuar me urdhrin nr. 106, datë 01.12.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 2020-2022”, ku janë detajuar objektivat strategjike, ato specifike, aktivitetet/masat, afati i kryerjes së këtyre aktiviteteve, kostot dhe burimet financiare. Plani u miratua dhe u publikua, më 1 dhjetor 2020, në faqen zyrtare të internetit.

## **KREU II - METODOLOGJIA E PËRDORUR**

Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, parashikon treguesit kryesorë të performancës, me qëllim matjen e arritjeve, metodave të koordinimit, monitorimit dhe raportimit, si dhe buxhetin e përgjithshëm të zbatimit të tij. Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit 2021-2022, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, konsiston në:

- **4 (katër) Objektiva Strategjike;**
- **15 (pesëmbëdhjetë) Objektiva Specifike/nëobjektiva;**
- **44 (dyzet e katër) Aktivitete/Masa;**
- **2 (dy) Indikatorë nga Pasaporta e Indikatorëve/Treguesve (sipas SND).**

Plani Strategjik dhe qëllimet strategjike gjenden të përcaktuara në **4 (katër) objektiva të përgjithshëm**, ku secili prej tyre përcakton qëllimin e përgjithshëm, i zbërthyer në 15

(pesëmbëdhjetë) Objektiva Specifike të shpërndara përkatësisht në 44 (dyzet e katër) aktivitete/masa, me një përshkrim të rezultateve të pritshme, që do të arrihen gjatë periudhës së strategjisë bashkë me treguesit përkatës, të cilët do të shërbejnë si tregues të qartë (cilësorë dhe sasiorë) në drejtim të vlerësimit të arritjes së secilit objektiv strategjik.

Planifikimi i këtyre nënobjektivave synon të intensifikojë organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndërsa masat konkrete në drejtim të zhvillimit strukturor, organizativ dhe përmirësimit të kapaciteteve njerëzore e profesionale janë parashikuar për të bërë të mundur zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga strategjia.

Në zbatim të këtyre nënobjektivave, janë parashikuar ndër të tjera një sërë masash dhe aktivitete, të cilat lidhen me organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përputhje me standardet evropiane. Këto parashikime janë mbajtur në konsideratë edhe gjatë konceptimit të masave dhe aktiviteteve në kuadër të këtij plani strategjik.

Për sa i përket transparencës dhe rritjes së aksesueshmërisë ndaj veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë parashikuar një sërë masash dhe aktivitete, të cilat lidhen me rritjen e transparencës, sigurimin e aksesit të publikut tek informacioni në rastet e interesit publik, përmirësimin e marrëdhënieve me median.

Për sa i përket aplikimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI), të administrimit dhe përmirësime të tjera në infrastrukturë, janë parashikuar masa dhe aktivitete të cilat lidhen me përmirësimin e funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Konkretisht në mënyrë që të sigurohet forcimi dhe realizimi i objektivave të ILD-së është parashikuar të sigurohet dhe të jetë funksional edhe infrastruktura e nevojshme e TI-së. Për këtë qëllim përfshirja e masave konkrete për zhvillimin e teknologjisë, duke filluar me pajisjen e infrastrukturës së nevojshme që ka të bëjë me sigurimin e dhomës së serverit, furnizimin e nevojshëm me bazën materiale për vënien në funksion të serverit, si dhe zhvillimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, i cili do të jetë një sistem bashkëkohor me synimin për të digjitalizuar dokumentacionin e Protokoll-Arkivit, mbledhjen dhe analizën e provave dhe procedimin e ankesës në mënyrë digjitale.

Sistemi i menaxhimit të çështjeve mundëson mbledhjen e të dhënave, gjenerimin e raporteve, ndërlikohet me sisteme të tjera komunikimi elektronik dhe nxitjen e pyetjeve të sofistikuar për mbledhjen e të dhënave, duke përmirësuar kështu efikasitetin e organizimit dhe funksionimit.

Përveç sa më sipër, janë parashikuar ndër të tjera një sërë masash dhe aktivitete, të cilat lidhen me përmirësimin e funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke siguruar hartimin dhe zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, integritetin dhe përgjegjshmërinë në menaxhimin operacional, me qëllim garantimin e përmbushjes me efikasitet dhe efektivitet të përgjegjësi dhe kompetencave kushtetuese të këtij institucioni.

Në kuadër të Objektivave Specifike të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i lind detyrimi të marrë një sërë masash me synim rritjen e transparencës në raport me veprimtarinë e tij, si dhe përmirësimin e aksesit të qytetarëve në informacion. Ky synim është parashikuar të arrihet nëpërmjet krijimit të strukturave të nevojshme për zbatimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe planifikimit të aktiviteteve të ndryshme me qëllim informimin dhe vënien në dispozicion të publikut, nëpërmjet publikimit në faqen

zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të të gjitha akteve nënligjore që parashikojnë procedurat e trajtimit të ankesave, afateve të paraqitura pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe formularit të ankesave.

Për sa i përket përmirësimit të efikasitetit, kontrollit, inspektimit dhe përdorimit sistematik të analizave të riskut janë parashikuar një sërë masash, të cilat pasqyrojnë zbatimin e një plani të përgjithshëm, organizativ, strukturor, infrastrukturor apo metodave të punës mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave funksionale të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilat kanë të bëjnë me verifikimin, hetimin apo zhvillimin e inspektimeve tematike apo institucionale. Kjo është planifikuar të zhvillohet nëpërmjet një qasjeje parandaluese, ndërgjegjësuese, mbikëqyrëse, apo ndëshkuese. Në të njëjtën kohë është synuar ngritja dhe rritja e kapaciteteve të strukturës së auditit të brendshëm, e cila do të garantojë efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në institucion.

Gjithashtu në kuadër të forcimit të integritetit të stafit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë parashikuar një sërë masash të cilat kanë të bëjnë me rritjen e kapaciteteve të stafit për sistemin e testimit të integritetit, zbatimin e procedurave të testimit të integritetit në mënyrë të vazhdueshme, si dhe përfshirja e pyetjeve që lidhen me integritetin në testimet për rekrutimin e administratës, apo përfshirja e këtyre kriterëve për pozicionet e punës.

Ndërsa në kuadër të rritjes së transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve buxhetore, në funksion të garantimit të transparencës janë parashikuar një sërë masash të cilat kanë të bëjnë me publikimin në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të fondeve buxhetore të akorduara në zbatim të ligjit vjetor të buxhetit dhe procedurave të prokurimit publik të kryera nga ky institucion.

Në kuadër të Objektivave Specifike të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2015-2020, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i lind detyrimi të marrë një sërë masash me synim zhvillimin e politikave planifikuese dhe koordinuese me qëllim përmirësimin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të dokumenteve strategjike nëpërmjet mbledhjes së të dhënave, hartimin dhe zbatimin e legjislacionit.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm, është edhe fuqizimi i strukturave të administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut, si dhe zhvillimi i një infrastrukture TIK të aftë për të mbështetur veprimtaritë e përditshme të administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kjo është parashikuar të realizohet nëpërmjet aplikimit të metodave të punës dhe mjeteve të teknologjisë së informacionit duke ulur kohën për të aksesuar, përpunuar dhe transmetuar informacionin, me qëllim përmirësimin e rrjedhës së informacionit përgjatë punës së përditshme.

Gjithashtu me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mënyrë të pavarur, eficiente dhe profesionale nëpërmjet masave të parashikuara synohet qëndrueshmëria, profesionalizmi i administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, zbatimi me rigorozitet i

legjislacionit për kryerjen e procedurave të rekrutimit, si dhe rritja e përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mban në konsideratë edhe një grup parimesh funksionale me qëllim përmbushjen e standardeve lidhur me procesin e integritetit evropian. Kjo është realizuar nëpërmjet kombinimit të veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me atë të proceseve integruese të vendit duke bërë të mundur, për sa diktohet edhe në Progres-Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2020, sjelljen e rezultateve konkrete dhe të besueshme me qëllim forcimin dhe konsolidimin e pavarësisë, paanësisë, profesionalizmin nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të verifikuar dhe hetuar në mënyrë efektive numrin e madh të backlog-ut (ankesave të mbartura) në funksion të garantimit të llogaridhënies së sistemit të drejtësisë.

Zbatimi i Planit Strategjik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është mbështetur nga burime financiare, të cilat janë përlllogaritur duke iu referuar buxhetit afatmesëm të shtetit, të alokuar në PBA 2020-2022 dhe në PBA 2021-2023, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu, në përlllogaritjen e nevojave financiare janë marrë në konsideratë edhe projektet me financim të huaj (në vijim ose të planifikuara) në fushën e drejtësisë.

### **KREU III - MONITORIMI DHE RAPORTIMI**

Në kuadër të zbatimit dhe monitorimit të Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit 2020-2022, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka miratuar urdhrin nr. 14, datë 27.01.2021 “Për mënyrën e raportimit dhe monitorimit të planit strategjik dhe planit të veprimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Bazuar në urdhrin e sipërpërmendur, janë përcaktuar aspekte të karakterit rregullues të procesit të monitorimit, detyrimi për raportim sipas çështjeve që mbulojnë njësitë që kanë në objekt të veprimtarisë masa apo aktivitete konkrete, afatet dhe struktura përgjegjëse për monitorimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit 2020-2022. Sektori i Raportimeve dhe Përfaqësimit, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike në funksion të monitorimit, kërkon përcjelljen e informacionit përkatës, koordinon dhe përpunon të dhënat e përcjella nga secila strukturë përgjegjëse për raportim, koncepton informacion përmbledhës për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë mbi nivelin e zbatimit të Planit të Veprimit dhe Planit Strategjik.

Kjo strukturë koordinon informacionin e përcjellë nga secila njësi përgjegjëse, dhe bashkëpunon me sektorin e Buxhetit dhe Financës në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë ILD-së, për përlllogaritjen në përqindje të realizimit të masave përkatëse.

Procesi i monitorimit dhe i vlerësimit realizohet nga ana e strukturave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet monitorimit në vazhdimësi të nivelit të zbatimit të planit strategjik në përputhje me afatet e parashikuara në planin e veprimit; raportimin periodik mbi nivelin e zbatimit të secilit aktivitet/masë sipas fushës së veprimtarisë

së secilës njësi organizative të Zyrës së ILD; bashkërendimin e aktiviteteve dhe strukturave përkatëse në rastet e vonesave apo moszhvillimin e aktiviteteve të planifikuara, si dhe harmonizimin me dokumentet e tjerë strategjik dhe burimet financiare të parashikuara për periudhën 2020-2022.

Ndërsa raportimi i zbatimit të planit të veprimit realizohet në baza periodike 3-mujore bazuar në raportet e strukturave (njësive organizative) të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim ngritjen e një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit nga të gjitha njësitë organizative të përfshira në zbatimin e planit strategjik dhe planit të veprimit.

Në përfundim të çdo periudhe monitorimi, Sektori i Raportimeve dhe Përfaqësimit informon Inspektorin e Lartë të Drejtësisë mbi përmbushjen e objektivave/masave për periudhat përkatëse të paracaktuara, mbi zbatimin e masave të *“Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 2020-2022”*, bashkë me përlogaritjen në përqindje (%), si një kriter matës mbi përmbushjen e aktiviteteve sipas çdo objekti specifik.

#### **KREU IV - ANALIZA E PLANIT TË VEPRIMIT GJATË NJË VITI RAPORTIMI**

Gjatë një viti raportimi (Dhjetor 2020-Dhjetor 2021) është përcjellë informacioni i përgjithshëm mbi realizimin e çdo mase/aktivitet, Objektiv Specifik dhe Objektiv Strategjik.

Përkatësisht realizimi i objektivave strategjike dhe masave të tyre përkatëse, gjatë periudhës Dhjetor 2020-Dhjetor 2021 janë realizuar si më poshtë:

#### **OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: “FUQIZIMI DHE USHTRIMI I VEPRIMTARISË SË ILD-SË NË MËNYRË TË PAVARUR, EFIÇIENTE DHE PROFESIONALE”, ËSHTË REALIZUAR NË NIVELIN 80%.**

- **Objektivi Specifik 1.1:** “Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e funksioneve nga ana Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet sigurimit të hapësirave, mjediseve, pajisjeve dhe kushteve të punës” është **realizuar në nivelin 39.19%, nga monitorimi i 6 masave të vendosura për realizimin e tij. Konkretisht:**

<b>1.1.1</b>	Sigurimi i ambienteve (selia e ILD) të nevojshme për ushtrimin e funksioneve dhe zbatimin e objektivave ligjore.
<b>1.1.2</b>	Rikonstruksioni i ambienteve të brendshme për pajisjen me ambiente pune për të gjithë nr. e punonjësve sipas strukturës dhe organikës së miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 28/2020.
<b>1.1.3</b>	Sigurimi i ambienteve të posaçme me standardet teknike për pajisjet e zhvillimit të teknologjisë së informacionit (dhomë e pavarur serveri), në përputhje me standardet Evropiane.



1.1.4	Zhvillimi i sistemit për lidhjen me rrjetin “Portën Qeveritare” që mundëson hyrjen në sistemet IT të institucioneve të drejtësisë, KLGJ/KLP të nevojshme për punën e ILD-së.
1.1.5	Planifikimi i bazës logjistike të nevojshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, për numrin e përgjithshëm të punonjësve, të miratuar sipas strukturës dhe organikës së miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.
1.1.6	Pajisja e punonjësve me bazën logjistike të nevojshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj.

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021, nga 6 aktivitetet e parashikuara për Objektivin Strategjik 1, Objektivin Specifik 1.1, rezultojnë **realizuar plotësisht (100%) vetëm 1 aktivitet/masë, konkretisht:**

- Sigurimi i ambienteve (selia e ILD-së) të nevojshme për ushtrimin e funksioneve dhe zbatimin e objektivave ligjore. Aktiviteti është përfunduar në muajin dhjetor 2020, pas lirimit dhe nga Departamenti i Administratës Publike i ambienteve në zbatim të VKM nr. 507, datë 24.06.2020.

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021, tek Objektivin Strategjik 1, Objektivin Specifik 1.1 janë **realizuar pjesërisht 2 aktivitete/masa. Konkretisht:**

- Planifikimi i bazës logjistike të nevojshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, për numrin e përgjithshëm të punonjësve të miratuar sipas strukturës dhe organikës së miratuar nga Kuvendi, është **realizuar në nivelin 77.23%**. Për vitin 2020, plotësimi i nevojave të stafit me materiale dhe shërbimet e domosdoshme për kryerjen e funksioneve u realizua me 92.4% të buxhetit faktik në zërin “Shpenzime operative”. Për vitin 2021, mbështetur në ligjin nr. 137/2020

“Për buxhetin e vitit 2021”, shpenzimet operative të dedikuara për plotësimin e logjistikës së nevojshme për stafin deri në datë 29.12.2021 janë realizuar në masën 78.04% kundrejt planit vjetor në këtë zë.

- Pajisja e punonjësve me bazën logjistike të nevojshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, është **realizuar në nivelin 54.34%**. Me fondet buxhetore të vitit 2020 u realizua blerja e PC dhe UPS për 50 poste pune, si edhe pajisje printimi e fotokopjimi. Gjithashtu, gjatë vitit 2020, është mundësuar plotësimi i pjesshëm i posteve të punës me pajisje e orëdi zyre, nëpërmjet procedurave të transferimit pa pagesë nga KLGJ. Me buxhetin e miratuar për vitin 2021 është realizuar blerja e pajisjeve IT edhe për 24 poste pune, server, etj. Për vitin 2021 nuk u realizua blerja e pajisjeve të zyrave me fondin 7.3 milion lekë të miratuar në buxhet. Gjatë vitit 2021, me transferim pa pagesë, janë marrë në dorëzim nga Departamenti i Administratës Publike pajisje zyre në vlerën 1.7 milion lekë.

Mbështetur në analizën e aktiviteteve dhe përqindjes së realizimit të tyre, është konstatuar se tek Objektivin Strategjik 1, Objektivin Specifik 1.1, **3 aktivitete/masa** janë në nivele të ulta dhe duhet të prioritetizohen në vijimësi, pasi indikatorët e tyre janë në nivele shumë të ulta, ose zero. Konkretisht:

- Referuar Objektivit Strategjik 1; “Fuqizimi dhe ushtrimi i veprimtarisë së ILD-së në mënyrë të pavarur, efiçiente dhe profesionale”, Objektivit Specifik 1. 1, “Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e funksioneve nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet sigurimit të hapësirave, mjediseve, pajisjeve dhe kushteve të punës” aktiviteti 2, “Rikonstruksioni i ambienteve të brendshme për pajisjen me ambiente pune për të gjithë numrin e punonjësve sipas strukturës dhe organikës së miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 28/2020”, është **realizuar në nivelin 3. 57%**.

- Referuar Objektivit Strategjik 1 “Fuqizimi dhe ushtrimi i veprimtarisë së ILD-së në mënyrë të pavarur, efiçiente dhe profesionale”, objektivi specifik 1. 1, “Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e funksioneve nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet sigurimit të hapësirave mjediseve, pajisjeve dhe kushteve të punës”, aktiviteti 3, “Sigurimi i ambienteve të posaçme me standardet teknike për pajisjet e zhvillimit të teknologjisë së informacionit (dhomë e pavarur serveri), në përputhje me standardet Evropiane”, është **realizuar në nivelin 0%**.

- Referuar Objektivit Strategjik 1; “Fuqizimi dhe ushtrimi i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mënyrë të pavarur, efiçiente dhe profesionale”, objektivi specifik 1. 1, “Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e funksioneve nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet sigurimit të hapësirave mjediseve, pajisjeve dhe kushteve të punës”, aktiviteti 4 “Zhvillimi i sistemit për lidhjen me rrjetin “Portën Qeveritare” që mundëson hyrjen në sistemet TI të institucioneve të drejtësisë, KLGJ/KLP të nevojshme për punën e ILD”, është **realizuar në nivelin 0%**.

➤ **Objektivi Specifik 1. 2:** “Sigurimi i autonomisë financiare dhe administrative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është **realizuar në nivelin 77 %**, nga monitorimi i 2 masave të vendosura për realizimin e tij. **Konkretisht:**

1. 2. 1	Plotësimi i vendeve vakante në institucion.
1. 2. 2	Hartimi i kërkesave buxhetore.

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021, tek Objektivit Strategjik 1, Objektivit Specifik 1. 2, të dyja masat/aktivitetet, janë realizuar pjesërisht. Konkretisht:

- Plotësimi i vendeve vakante në institucion, është **realizuar në nivelin 69%**. Nisur nga struktura e miratuar e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë e cila përmban 93 pozicione, rezulton që aktualisht në datë 28.12.2021 pranë ILD-së ka 64 emërimet dhe 29 vende vakante.
- Hartimi i kërkesave buxhetore, është **realizuar në nivelin 85%**. Për vitin 2022, në PBA 2022-2024 është përfshirë 85 % e kërkesave buxhetore.

- **Objektivi Specifik 1. 3:** “Përmirësimi i menaxhimit dhe komunikimit të brendshëm organizativ të administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është **realizuar në nivelin 87. 50%, nga monitorimi i 4 masave të vendosura për realizimin e tij. Konkretisht:**

<b>1. 3. 1</b>	Përfundimi i përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet.
<b>1. 3. 2</b>	Hartimi i rregullores për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
<b>1. 3. 3</b>	Njësimi i dokumenteve administrative të nxjerra nga ILD.
<b>1. 3. 4</b>	Hartimi i rregullores së roleve dhe përdorimit të sistemit.

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021 në Objektivin Strategjik 1, Objektivi Specifik 1. 3, është realizuar plotësisht (100%), 3 aktivitete/masa. Konkretisht:

- Përfundimi i përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet. Në dhjetor 2020 janë përfunduar 48 përshkrime pune për pozicionet pjesë e shërbimit civil. Sa i takon pozicioneve inspektor jo magjistrat dhe inspektor magjistrat detyrat dhe kriteret janë të përcaktuara në ligjin nr. 115/2016, i ndryshuar.
- Hartimi i rregullores për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Lidhur me këtë aktivitet është miratuar urdhri nr. 119, datë 12.07.2021 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.
- Njësimi i dokumenteve administrative të nxjerra nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Lidhur me këtë aktivitet është miratuar urdhri nr. 58, datë 18.09.2020, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për njësimin e dokumentit administrativ”.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2021 në Objektivin Strategjik 1, Objektivi Specifik 1. 3, është **realizuar pjesërisht 1 aktivitet/masë. Konkretisht:**

- Hartimi i rregullores së roleve dhe përdorimit të sistemit, është **realizuar në nivelin 50%**. Lidhur me këtë aktivitet, sistemi është përfunduar dhe dorëzuar nga Misioni Euralius V, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ndërkohë Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është në proces draftimi të projektit rregullues.
- Tek Objektivi Strategjik 1 “Fuqizimi dhe ushtrimi i veprimtarisë së ILD-së në mënyrë të pavarur, eficiente dhe profesionale”, Objektivi Specifik 1. 3 “Përmirësimi i menaxhimit dhe komunikimit të brendshëm organizativ të administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, aktiviteti 1. 1. 4, “Hartimi i rregullores së roleve dhe përdorimit të sistemit”, është **realizuar në nivelin 20%**.

- **Objektivi Specifik 1. 4:** “Zhvillimi i sistemit të teknologjisë së informacionit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është **realizuar në nivelin 100% nga monitorimi i 3 masave të vendosura për realizimin e tij. Konkretisht:**

<b>1. 4. 1</b>	Hartimi i projektit/termave të referencës së sistemit të menaxhimit të çështjeve.
<b>1. 4. 2</b>	Pajisja me software specifik për menaxhimin e dokumentacionit.
<b>1. 4. 3</b>	Trajnime specifike për përdoruesit e sistemit.

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021 në Objektivin Strategjik 1, Objektivi Specifik 1. 4, janë

**realizuar plotësisht (100%) të 3 aktivitetet/masat. Konkretisht:**

- Hartimi i projektit/termave të referencës së sistemit të menaxhimit të çështjeve”. Sistemi i menaxhimit të ankesave dhe dokumenteve (SMAD) është dorëzuar nga ekspertët e huaj dhe është marrë në dorëzim sipas marrëveshjes së nënshkruar me nr. 4462/2 prot., datë 30.12.2021.
  - Pajisja me software specifik për menaxhimin e dokumentacionit”. Në lidhje me sistemet e menaxhimit të ankesave dhe dokumenteve zyrtare (SMAD) dhe menaxhimit të Burimeve Njerëzore, është kryer instalimi i software si dhe pilotimi i software.
  - Trajnime specifike për përdoruesit e sistemit. Gjatë vitit 2021 rezultojnë të jenë kryer 3 trajnime: 1 me inspektorë dhe ndihmës inspektorë për përdorimin e sistemit (SMAD), 1 me zyrën e Burimeve Njerëzore për përdorimin e sistemit të BNJ dhe 1 me zyrën IT për menaxhimin e sistemit (SMAD).
- **Objektivi Specifik 1. 5:** “Rritja e njohurive dhe aftësive profesionale të inspektorëve dhe nëpunësve civilë, në mënyrë që secili prej tyre, në pozicionin përkatës të përmbushë në mënyrë eficiente detyrat e tij funksionale”, është **realizuar në nivelin 77 %. %, nga monitorimi i 3 masave të vendosura për realizimin e tij. Konkretisht:**

<b>1. 5. 1</b>	Bashkëpunimi me ASPA, Shkollën e Magjistraturës dhe ekspertë të huaj për ofrimin e trajnimeve.
<b>1. 5. 2</b>	Ngritje e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve specifike për pozicionet e punës.
<b>1. 5. 3</b>	Konceptimi i termave të trajnimit në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe ekspertë të huaj.

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021 në Objektivin Strategjik 1, Objektivi Specifik 1. 5, është **realizuar plotësisht (100%), 1 aktivitet/masë. Konkretisht:**

- Ngritje e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve specifike për pozicionet e punës. Për periudhën Dhjetor 2020-Shkurt 2021 janë ndjekur 29 trajnime; Për periudhën Mars-Maj 2021 janë ndjekur 244 trajnime; Për periudhën Qershor-Gusht 2021 janë ndjekur 63 trajnim edhe për periudhën Shtator-Dhjetor 2021 janë ndjekur 151 trajnime.

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021 në Objektivin Strategjik 1, Objektivin Specifik 1. 5, janë **realizuar pjesërisht 2 aktivitete/masë. Konkretisht:**

- Bashkëpunimi me ASPA, Shkollën e Magjistraturës dhe ekspertë të huaj për ofrimin e trajnimeve. është **realizuar në nivelin 80%**. Planifikimi dhe formalizimi i kërkesave për bashkëpunim me ASPA me shkresën nr. 831, datë 18.06.2021, ka përcjellë raportin mbi vlerësimin e nevojave për trajnim 2021-2022 për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpërndara në nivel njësie/drejtorie: Totali i temave të trajnimit të planifikuara është 169.
- Konceptimi i termave të trajnimit në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe ekspertë të huaj është **realizuar në nivelin 50%**. Në total Dhjetor 2020-Dhjetor 2021 janë ndjekur 497 trajnime.
- **Objektivi specifik 1. 6:** “Ngritja e një sistemi efektiv, transparent dhe objektiv të vlerësimit të performancës së inspektorëve”, është **realizuar në nivelin në masën 100% nga monitorimi i 3 masave të vendosura për realizimin e tij. Konkretisht:**

<b>1. 6. 1</b>	Hartimi i rregullores për vlerësimin e inspektorëve.
<b>1. 6. 2</b>	Ngritja e Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të performancës.
<b>1. 6. 3</b>	Hartimi i rregullave për kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo magjistratë.

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021 janë **realizuar plotësisht (100 %) të 3 aktivitetet/masë. Konkretisht:**

- Hartimi i rregullores për vlerësimin e inspektorëve. Lidhur me këtë aktivitet/masë, është miratuar vendimi nr. 38, datë 08.06.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e procedurave dhe rregullave të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve”.
- Ngritja e Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve. Lidhur me këtë aktivitet është miratuar urdhri nr. 14 , datë 23.04.2020 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.
- Hartimi i rregullave për kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo magjistratë. Lidhur me këtë aktivitet, është miratuar urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020 “Për miratimin e rregullores për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: “ZHVILLIMI I PROCESIT TË VERIFIKIMIT, HETIMIT DISIPLINOR DHE INSPEKTIMIT NË PËRPTHJE ME PARIMET E PROCEDIMIT DISIPLINOR DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE”, ËSHTË REALIZUAR NË NIVELIN 62 %.**

- **Objektivi Specifik 2. 1:** “Krijimi i bazës për interpretimin dhe zbatimin e duhur të kuadrit të ri ligjor që ka të bëjë me veprimtarinë lidhur me përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve”, është **realizuar në nivelin 100 %**, nga monitorimi i 1 mase të vendosur për realizimin e tij. **Konkretisht:**

2. 1. 1	Hartimi i manualit të hetimit disiplinor ku përfshihet edhe komentari i ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
---------	---

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021 është **realizuar plotësisht (100%) aktiviteti 2. 1. 1, konkretisht:**

- Hartimi i manualit të hetimit disiplinor ku përfshihet edhe komentari i ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në zbatim të këtij objekti, është hartuar Manuali për Hetimin Disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në bashkëpunim me ekspertë të Misionit Euralius V. Ky manual u prezantua në trajnimin për fuqizimin e kapaciteteve të inspektorëve, ndihmës inspektorëve dhe anëtarëve të kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të zhvilluar gjatë datave 20-21.05.2021 dhe atë të datës 27.05.2021 mbi hetimin disiplinor në Shqipëri me administratën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- **Objektivi Specifik 2. 2:** “Standardizimi/unifikimi i metodave dhe proceseve të punës për trajtimin e ankesave apo zhvillimin e veprimtarisë inspektuese dhe hetimore” është **realizuar në nivelin 0% nga monitorimi i 2 masave të vendosura për realizimin e tij. Konkretisht:**

2. 2. 1	Hartimi i rregullores për trajtimin e ankesave.
2. 2.2	Hartimi i metodologjisë për inspektimin.

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021, në Objektivin Strategjik 2, Objektivi Specifik 2. 2, të dyja masat **rezultojnë të porealizuara (0%). Konkretisht:**

- Hartimi i rregullores për trajtimin e ankesave, është **realizuar në nivelin 0%**. Me qëllim finalizimin e rregullores së trajtimit të ankesave, nevojitet një përshkrim i detajuar i metodës së punës që ndjekin inspektorët dhe ndihmës inspektorët, qarkullimit të dokumentacionit, procedurat që ndjekin dhe afatet e nevojshme për trajtimin e ankesave. Përshkrimi duhet të vihet në dispozicion me qëllim që të iniciohet projekt-akti përkatës.
- Hartimi i metodologjisë për inspektimin. Lidhur me këtë aktivitet, ecuria e zbatimit është në proces, është **realizuar në nivelin 0%**.

Sa i takon metodologjisë së inspektimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë për shkak të numrit të pamjaftueshëm të inspektoreve dhe numrit të lartë të ankesave të mbartura, deri tani kanë filluar 3 inspektime tematike:

1. Për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me kusht”.

2. Për kryerjen e inspektimit tematik të juridiksionit të përgjithshëm me objekt: “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar.”

3. “Për kryerjen e inspektimit tematik të prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm me objekt: “Respektimi i kushteve dhe kritereve për caktimin e masave të sigurimit personal për veprën penale “Të mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”.

Në secilin prej vendimeve për kryerjen e Inspektimeve Tematike, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka miratuar edhe metodologjinë e inspektimit që do të ndiqet. Analiza e të dhënave dhe rezultateve në këto dy raste do të shërbejnë si pikënisje për fillimin e punës për hartimin e metodologjisë së përgjithshme.

Në këtë fazë të kapaciteteve të burimeve njerëzore kjo masë mbetet për t’u realizuar pjesërisht, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të inspektorëve dhe trajtimit të ankesave të prapambetura nga ish-KLD, KLGj dhe atyre aktuale, por edhe të mungesës së infrastrukturës së nevojshme për realizimin e inspektimeve.

➤ **Objektivi Specifik 2. 3:** “Qasja e metodave/proceseve të punës me standardet ndërkombëtare për hetimin disiplinor dhe inspektimin”, është **realizuar në nivelin 75%, nga monitorimi i 2 masave të vendosura për realizimin e tij. Konkretisht:**

2. 3. 1	Analizim të dispozitave ligjore në raport me standardet ndërkombëtare.
2. 3. 2	Adresimi i nevojës për ndryshime ligjore.

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021 në Objektivin Strategjik 2, Objektivin Specifik 2. 3, është **realizuar plotësisht (100%) 1 aktivitet/masë. Konkretisht:**

➤ Adresimi i nevojës për ndryshime ligjore. Lidhur me këtë aktivitet, gati një vit pas konstituimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, lindi nevoja për ndryshime ligjore. Konkretisht në ligjin nr. 115/2016 dhe në ligjin nr. 96/2016 u propozua ndryshimi i dispozitave ligjore për sa i përket plotësimit të vakancave të pozicioneve të inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, trajtimit të njëjtë financiar të inspektorëve dhe rregullimit të marrëdhënies së ILD dhe inspektorëve gjatë fazës së verifikimit të ankesave, hetimit disiplinor dhe inspektimit. Këto propozime janë konkretizuar duke i dërguar Ministrisë së Drejtësisë shkresën nr. 2922 prot., datë 2.12.2020 për të vënë në lëvizje iniciativën përkatëse, por nuk u shqyrtuan brenda legjislaturës së IX.

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021 në Objektivin Strategjik 2, Objektivin Specifik 2. 3, është

**realizuar pjesërisht 1 aktivitet/masë: Konkretisht:**

- Analizim të dispozitave ligjore në raport me standardet ndërkombëtare, është **realizuar në nivelin 50%**. Lidhur me këtë aktivitet, pas rekrutimit të stafit administrativ të Zyrës të ILD-së, do të vijojë procedura e analizimit të dispozitave ligjore konform standardeve ndërkombëtare në fushën përkatëse në hetimin administrativ për shkeljet disiplinore. Gjithashtu, do të bëhet analiza juridike e jurisprudencës së mundshme që mund të ketë në një të ardhme nga GJL/GJK dhe GJEDNJ. Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjithashtu, ka miratuar manualin “Për hetimin disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve” në të cilin është bërë dhe një përmbledhje e përgjegjësisë disiplinore e gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas standardeve Evropiane. Në konceptimin e manualit, kanë marrë pjesë anëtarë të kabinetit dhe përfaqësues të DALHA-së gjatë hartimit të manualit e për pasojë kanë kontribuar në identifikimin e standardeve vendase e të huaja.

- **Objektivi Specifik 2. 4:** “Rritja e numrit të ankesave të trajtuara në përputhje me afatet ligjore”, është **realizuar në nivelin 73%, nga monitorimi i 3 masave të vendosura për realizimin e tij. Konkretisht:**

2. 4. 1	Ngritja e grupeve të punës për evidentimin dhe kategorizimin e ankesave të mbartura nga institucionet e tjera, sipas objektit.
2. 4. 2	Hartimi i akteve nënligjore për trajtimin e posaçëm të ankesave të mbartura nga institucionet e tjera.
2. 4. 3	Shqyrtimi me prioritet i ankesave sipas gjetjeve të grupeve të punës për evidentimin dhe kategorizimin e ankesave të mbartura nga institucionet e tjera, sipas objektit.

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021 në Objektivin Strategjik 2, Objektivi Specifik 2. 4, janë **realizuar plotësisht (100%) 2 aktivitete/masa. Konkretisht:**

- Ngritja e grupeve të punës për evidentimin dhe kategorizimin e ankesave të mbartura nga institucionet e tjera, sipas objektit. Lidhur me këtë aktivitet, ecuria e zbatimit ka përfunduar duke konkluduar në 4 urdhra që evidentojnë ngritjen e grupeve të punës sipas strukturave përgjegjëse të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Urdhri nr. 41, datë 19/02/2021 “Për shpërndarjen e ankesave të mbartura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe të administruara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të drejtësisë. Urdhri nr. 66, datë 28.09.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për administrimin dhe kategorizimin e ankesave të dorëzuara pranë organeve kompetente gjatë periudhës kalimtare deri në krijimin e institucionit të inspektorit të lartë të drejtësisë”. Urdhri nr. 98, datë 12.11.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për vazhdimin e trajtimit të ankesave apo praktikave të përcjella nga KLGJ pranë ILD”. Urdhri nr. 37, datë 15.02.2021 “Për shpërndarjen e ankesave me objekt magjistratë/prokurorë të administruara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.



- Hartimi i akteve nënligjore për trajtimin e posaçëm të ankesave të mbartura nga institucionet e tjera. Lidhur me këtë aktivitet, është miratuar urdhri 98, datë 12.11.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për vazhdimin e trajtimit të ankesave apo praktikave të përcjella nga KLGJ pranë ILD”

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021 në Objektivin Strategjik 2, Objektiv Specifik 2. 4, rezulton të jetë realizuar në nivele të ulta 1 aktivitet masë. Konkretisht:

- Shqyrtimi me prioritet i ankesave sipas gjetjeve të grupeve të punës për evidentimin dhe kategorizimin e ankesave të bartura nga institucionet e tjera sipas objektit, është **realizuar në nivelin 20%**. Gjatë vitit 2021 janë trajtuar 427 ankesa nga fondi i bartur.

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: “PJESËMARRJA AKTIVE NË PROCESET E KOORDINIMIT DHE ZHVILLIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL”, ËSHTË REALIZUAR NË NIVELIN 100 % .**

- **Objektivi Specifik 3. 1:** “Zhvillimi i një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit nga të gjitha njësitë organizative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për hartimin, monitorimin dhe raportimin në lidhje me proceset e planifikimit strategjik”, është **realizuar në nivelin 100%, nga monitorimi i 3 masave të vendosura për realizimin e tij. Konkretisht:**

<b>3. 1. 1</b>	Identifikim i raporteve ku jep kontribut Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
<b>3. 1. 2</b>	Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve vendase apo ndërkombëtare sipas raporteve përkatëse.
<b>3. 1. 3</b>	Koordinimi brenda strukturave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sipas afateve të përcaktuara për raportim.

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021, në Objektivin Strategjik 3, Objektiv Specifik 3. 1 rezulton të jenë **realizuar plotësisht (100%) të 3 aktivitetet/masat. Konkretisht:**

- Identifikim i raporteve ku jep kontribut Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
  1. Raportim periodik në kuadër të përmbushjes së treguesve të pasaportës së indikatorëve dhe Planit të Veprimit për Strategjinë Ndërsektoriale 2021-2025;
  2. Raportim periodik për përmbushjen e indikatorëve në zbatim të Kontratës Sektoriale “BE për Reformën në Drejtësi”, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian;
  3. Raportim periodik për zbatimin e rekomandimeve të Progres Raportit Vjetor të Komisionit Evropian për Shqipërinë;
  4. Raportim periodik për zbatimin e rekomandimeve të Nënkomitetit “Drejtësia, Liria dhe Siguria”;

5. Raportim periodik për zbatimin e rekomandimeve për Kapitullin 23, të Progres Raportit “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore dhe Kriterin Politik”;

6. Raportim në zbatim të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian për periudhën 2022-2024;

7. Përmbledhje Vjetore Ekzekutive, për reformën në drejtësi për vitin 2020;

8. Në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për Shqipërinë, në funksion të aktiviteteve dhe takimeve periodike të përbashkëta, raportim për Nënkomitetin: Bashkimi Evropian-Shqipëri “Drejtësia, Liria dhe Siguria”.

- Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve vendase apo ndërkombëtare sipas raporteve përkatëse. Lidhur me këtë aktiviteti DPÇSHJ ka evidentuar rekomandimet që Kuvendi i Republikës së Shqipërisë i ka propozuar ILD-së përmes një rezolute. DPÇSHJ ka përpiluar kalendarin e masave në zbatim të rekomandimeve të rezolutës dhe ka përcaktuar strukturat përgjegjëse që do të angazhohen për zbatimin e tyre, e cila është në pritje për miratim nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu, janë evidentuar rekomandimet e caktuara në Progres Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021.
- Koordinimi brenda strukturave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sipas afateve të përcaktuara për raportim. Në çdo raportim të kërkuar, pa patur koordinim të plotë mes strukturës përgjegjëse për raportimet me zyrën e Protokoll-Arkivit, me ndihmën inspektorët si dhe me çdo sektor tjetër nga i cili është kërkuar informacioni përkatës, brenda afateve të përcaktuara.

➤ **Objektivi specifik 3. 2:** “Ndjekja/realizimi i aktiviteteve që Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë ka parashikuar për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është **realizuar në nivelin 100%, nga monitorimi i 2 masave të vendosura për realizimin e tij. Konkretisht:**

3. 2. 1	Identifikimi i burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve.
3. 2. 2	Zbatimi i aktiviteteve sipas afateve kohore.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2021 në Objektivin Strategjik 3, Objektivi Specifik 3. 2, rezulton të jenë **realizuar plotësisht (100%) 2 aktivitete/masa. Konkretisht:**

- Identifikimi i burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve. Realizimi i aktiviteteve është parashikuar të realizohet me buxhetin e miratuar për ILD në ligjin vjetor përkatës.
- Zbatimi i aktiviteteve sipas afateve kohore. Në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planit të Veprimit 2021-2025, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka marrë pjesë deri tani në dy aktivitete të zhvilluara. Konkretisht në muajin qershor ku ILD u përfaqësua nga znj. Besmira Hysenbelliu, si dhe aktiviteti i zhvilluar në muajin korrik 2021, ku ishte i pranishëm Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani.

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: “RRITJA E TRANSPARENCËS DHE AKSESIT TË PUBLIKUT NË VEPRIMTARINË E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”, ËSHTË REALIZUAR NË NIVELIN 100 %.**

- **Objektivi specifik 4. 1:** “Rritja e aksesit të publikut përmes komunikimit dhe bashkëpunimit me qytetarët”, është **realizuar në nivelin 100%, nga monitorimi i 6 masave të vendosura për realizimin e tij. Konkretisht:**

<b>4. 1. 1</b>	Hartimi dhe publikimi i modelit të formularit të ankesës dhe udhëzuesit.
<b>4. 1. 2</b>	Ofrimi i faciliteteve infrastrukturore për të ngritur një njësi për pritjen me qytetarin.
<b>4. 1. 3</b>	Ofrimi i asistencës së nevojshme lidhur me takimet e mundshme dhe ofrimin e këshillimit për plotësimin e formularit.
<b>4. 1. 4</b>	Ofrimi i informacioneve (raporte, statistikave të gjeneruara nga sistemi), të thjeshtuar në faqen web.
<b>4. 1. 5</b>	Publikimi i rezultateve të inspektimit dhe vendimeve të marra në përputhje me parashikimet e ligjit, me një gjuhë të thjeshtuar për publikun.
<b>4. 1. 6</b>	Ofrimi i trajnimeve për personat përgjegjës për pritjen me qytetarin.

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021 tek Objektivi Strategjik 4, Objektivi Specifik 4. 1, rezulton të jenë **realizuar plotësisht (100%) 6 aktivitete/masa. Konkretisht:**

- Hartimi dhe publikimi i modelit të formularit të ankesës dhe udhëzuesit. Lidhur me këtë aktivitet, është miratuar Urdhri nr. 65, datë 28.09.2020, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e modelit të formularit të ankesës”.
- Ofrimi i faciliteteve infrastrukturore për të ngritur një njësi për pritjen me qytetarin. Lidhur me këtë aktivitet, aktualisht takimet zhvillohen në ambientet ekzistuese të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por me ristrukturimin e godinës do të ketë një ambient të dedikuar për pritjen e qytetarëve.
- Ofrimi i asistencës së nevojshme lidhur me takimet e mundshme dhe ofrimin e këshillimit për plotësimin e formularit. Sektori i ankesave çdo ditë të javës nga ora 09.00-14.00, pret qytetarët duke i asistuar në plotësimin e ankesës si dhe duke komunikuar me ta me qëllim lënien e takimeve për sqarime apo plotësim dokumentacioni.
- Ofrimi i informacioneve (raporteve, statistikave të gjeneruara nga sistemi), të thjeshtuar në faqen web. Për thjeshtësi të ofrimit të informacionit ndaj publikut, në faqen zyrtare (web) të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë publikuar: Raporti i punës 6-mujore e veprimtarisë së kryer nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe Raporti Vjetor i paraqitur edhe pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, në kuadër të informimit me punën që kryhet në institucion, çdo muaj botohet Buletini i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përmbajtje të të cilit do të jenë informacionet në lidhje me ankesat, aktivitetet dhe temat më kryesore dhe me interes të zhvilluara përgjatë një muaji.

- Publikimi i rezultateve të inspektimit dhe vendimeve të marra në përputhje me parashikimet e ligjit, me një gjuhë të thjeshtuar për publikun. Lidhur me këtë aktivitet, në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë publikuar disa modele orientuese mbi mënyrën e vendimmarrjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu, çdo jave (ditë e hënë), në faqen zyrtare publikohen shifrat zyrtare, lidhur me ankesat e konfirmuara, të trajtuara, hetimet disiplinore, kërkesat për procedim... etj.
- Ofrimi i trajnimeve për personat përgjegjës për pritjen me qytetarin. Lidhur me këtë aktivitet, janë kryer 2 trajnime të specialisteve të Sektorit të Ndihmës Juridike dhe Ankesave.
- **Objektivi specifik 4. 2:** “Zhvillimi i infrastrukturës dhe mjeteve të teknologjisë së informacionit me qëllim bashkëpunimin me publikun si dhe transparencën e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është **realizuar në nivelin 100%, nga monitorimi i 3 masave të vendosura për realizimin e tij.**  
**Konkretisht:**

4. 2. 1	Rikonceptimi i design të faqes zyrtare për lehtësimin dhe aksesueshmërinë e marrjes së informacionit.
4. 2. 2	Publikimi i informacionit për funksionimin e ILD-së në kuadër të transparencës.
4. 2. 3	Krijimi i kushteve për plotësimin e ankesave në formë elektronike dhe ngarkimi i dokumentacionit shoqërues.

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021, tek Objektivi Strategjik 4, Objektivi Specifik 4. 2, rezulton të jenë **realizuar plotësisht (100%) të 3 aktivitetet/masa. Konkretisht:**

- Rikonceptimi i design të faqes zyrtare për lehtësimin dhe aksesueshmërinë e marrjes së informacionit. Lidhur me këtë aktivitet, është realizuar rikonceptimi i faqes zyrtare të ILD-së. Gjatë vitit 2021, rezulton që faqja zyrtare të jetë vizituar nga 20. 832 vizitorë.
- Publikimi i informacionit për funksionimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në kuadër të transparencës. Lidhur me këtë aktivitet, në kuadër të transparencës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar Programin e Transparencës, i cili është i publikuar dhe i aksesueshëm në linkun: <https://ild.al/sq/programi-i-transparences/programi-i-transparences-i-ild/>. Sa i përket numrit të përgjithshëm të akteve të publikuara në faqen zyrtare gjatë vitit 2021, rezulton të jenë publikuar 273 akte.
- Krijimi i kushteve për plotësimin e ankesave në formë elektronike dhe ngarkimi i dokumentacionit shoqërues. Në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në linkun: <https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/>, janë të publikuara: Udhëzimi mbi plotësimin e formularit të ankesës, formulari i ankesës në formatin word (për shkarkim), si dhe formati i ankesës online.
- **Objektivi specifik 4. 3:** “Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat e sinjalizimit të

veprimeve ose praktikave të dyshuara të korrupsionit”, është **realizuar në nivelin 100%, nga monitorimi i 1 mase të vendosur për realizimin e tij. Konkretisht:**

#### 4.3.1

Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për sinjalizimin e veprimeve apo praktikave korruptive.

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021, tek Objektivi Strategjik 4, Objektivi Specifik 4.3, rezulton të jetë **realizuar plotësisht (100%) aktiviteti i vetëm i këtij objektivi. Konkretisht:**

- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për sinjalizimin e veprimeve apo praktikave korruptive. Lidhur me këtë aktivitet, gjatë vitit 2021 në kuadër të ndërgjegjësimit të publikut, mbi veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është punuar mbi këto drejtime:

1. Ristrukturimi i faqes zyrtare të webit: [www.ild.al](http://www.ild.al). Është krijuar një dizajn i ri për të krijuar lehtësi në hulumtim të çdo vizitori në faqe dhe për të kërkuar informacionin në kohë reale. Faqja ekziston në dy gjuhë, shqip dhe anglisht dhe informacioni përditësohet sistematikisht në të dy gjuhët, për t’u ofruar më tepër akses dhe lehtësi vizitorëve shqipfolës apo të huaj të faqes.

2. Mes publikimeve informuese dhe edukuese për qytetarët mbi veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është përgatitur dhe publikuar në faqe dhe në kanalën Youtube një material audiovizual 85 sekondësh prezantues i institucionit, detyrave dhe procesit të ankimimit ndaj magjistratëve.

3. Për të orientuar dhe lehtësuar procesin e ankimimit të qytetarëve ndaj magjistratëve në faqen e ILD, në zonën më të dukshme, ka një rubrikë të posaçme “Si pranohen ankesat”, ku shpjegohen etapat e paraqitjes së një ankese, formulari përkatës, si dhe jepen shembuj konkretë me problematika, që e sqarojnë në mënyrë shteruese këtë procedurë. Për të ilustruar më tej këtë proces është konceptuar dhe hartuar ankesën, në sistemin dygjuhësh, e cila pasqyron të gjitha fazat që ndjek ankesa, që prej depozitimit pranë ILD-së deri në përfundim të trajtimit të saj. Kjo hartë është paraqitur në mënyrë grafike, e thjeshtuar, për të qenë e aksesueshme nga çdo grupmoshë.

4. Qytetarët që duan të kryejnë fizikisht procesin e ankimimit në ILD, asistohen sipas nevojës nga Sektori i Ankesave, si strukturë përbërëse e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike, që i pret dhe i ndihmon në plotësimin e formularit TIP të ankesës çdo ditë të javës nga ora 09:00-14:00.

5. Adresa zyrtare e emailit [info@ild.al](mailto:info@ild.al) shërben si mjet tjetër komunikimi për dërgimin e ankesave, por jo vetëm kaq. Me anë të postës elektronike qytetarët mund të marrin çdo informacion që i nevojitet dhe të dërgojnë çdo dokumentacion të nevojshëm për të lehtësuar komunikimin me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

6. Për një mënyrë më shumë e më të shpejtë komunikimi, është vënë në dispozicion numri zyrtar i telefonit, ku qytetarët mund të kontaktojnë, në përputhje edhe me të drejtën e tyre të informimit.

7. Në faqen zyrtare të ILD jepen dhe përditësohen çdo javë shifrat e punës javore në institucion, lidhur me ankesat e konfirmuara, ankesat e trajtuara, ankesat në proces trajtimi, ankesa në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar, vendime për fillim hetimi disiplinor dhe kërkesa për procedim disiplinor. Shifrat freskohen çdo ditë të hënë.

8. Një përmbledhje mbi ecurinë mujore të punës, edhe në shifra, pasqyrohet në buletinin mujor, që publikohet në shqip dhe anglisht, po në faqen zyrtare të ILD-së, në ditën e parë të çdo muaji.

9. Komunikimi me publikun realizohet edhe përmes llogarisë zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në Twitter.

10. Për një komunikim më dinamik shërben edhe kanali zyrtar Youtube, në të cilin pasqyrohet çdo aktivitet mediatik i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me video.


11. Në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka caktuar koordinatorin për të drejtën e informimit, i cili ushtron të gjitha detyrimet dhe të drejtat sipas ligjit të sipërcituar.

Zbatueshmëria e masave të Planit të Veprimit klasifikohet me vlerat si më poshtë: Aktivitete të realizuara, për ato masa të cilat janë realizuar plotësisht. Aktivitete të realizuara pjesërisht: Është raportuar numri për ato aktivitete/masa, të cilat në periudhën e raportimit kanë patur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijojnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre. Aktivitete të porealizuara: Janë raportuar ato masa të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese si dhe gjithashtu ato masa për të cilat nuk ka patur progres.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2021 rezulton se gjithsej janë realizuar plotësisht (100%) **30 aktivitete nga 44 prej tyre. Konkretisht:**

Statusi i aktiviteteve	Numri i aktiviteteve	Pesha specifike ndaj totalit të masave/aktiviteteve (në %)
Aktivitete të realizuara plotësisht (100%)	30	68. 18%
Aktivitete të realizuara pjesërisht.	10	22. 72%

Aktivite të perealizuara.	4	9.09%
Gjithsej	44	100%



Nga shqyrtimi dhe analizimi i Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për Zyrë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021 rezulton si më poshtë vijon:

### 1. Mbështetur në analizën e periudhave të monitoruara:

- Gjatë periudhës **Dhjetor 2020-Shkurt 2021**, Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezulton të jetë realizuar në nivelin 74.75%, ndërsa pjesa tjetër e aktiviteteve është në proces.
- Gjatë periudhës **Mars-Maj 2021**, Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezulton të jetë realizuar në nivelin 80.75%, ndërsa pjesa tjetër e aktiviteteve është në proces.
- Gjatë periudhës **Qershor-Gusht 2021**, Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezulton të jetë realizuar në nivelin 82.50%, ndërsa pjesa tjetër e aktiviteteve është në proces.
- Gjatë periudhës **Shtator-Dhjetor 2021**, Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit për Zyrën e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezulton të jetë realizuar në nivelin 89.75%, ndërsa pjesa tjetër e aktiviteteve është në proces.

**2. Mbështetur në nivelin relativ të arritjes së çdo Objektivit Strategjik dhe Objektivit të Përgjithshëm, për periudhën progresive të raportimit Dhjetor 2020-Shkurt 2021, rezulton se:**

- Objektivit Strategjik nr. 1 është realizuar në nivelin 61%.
- Objektivit Strategjik nr. 2 është realizuar në nivelin 66%.
- Objektivit Strategjik nr. 3 është realizuar në nivelin 100%.
- Objektivit Strategjik nr. 4 është realizuar në nivelin 72%.
- Objektivit i Përgjithshëm (mesatarja e 4 Objektivave Strategjike) për periudhën Dhjetor 2020-Shkurt 2021 rezulton të jetë 74.75%.

**3. Mbështetur në nivelin relativ të arritjes së çdo Objektivit Strategjik dhe Objektivit të Përgjithshëm, për periudhën progresive të raportimit Mars 2021-Maj 2021, rezulton se:**

- Objektivit Strategjik nr. 1 është realizuar në nivelin 68%.
- Objektivit Strategjik nr. 2 është realizuar në nivelin 74%.
- Objektivit Strategjik nr. 3 është realizuar në nivelin 100%.
- Objektivit Strategjik nr. 4 është realizuar në nivelin 81%.
- Objektivit i Përgjithshëm (mesatarja e 4 Objektivave Strategjike) për periudhën Dhjetor 2020-Shkurt 2021 rezulton të jetë 80.75%.

**4. Mbështetur në nivelin relativ të arritjes së çdo Objektivit Strategjik dhe Objektivit të Përgjithshëm, për periudhën progresive të raportimit Qershor 2021-Gusht 2021, rezulton se:**

- Objektivit Strategjik nr. 1 është realizuar në nivelin 71%.
- Objektivit Strategjik nr. 2 është realizuar në nivelin 78%.
- Objektivit Strategjik nr. 3 është realizuar në nivelin 100%.
- Objektivit Strategjik nr. 4 është realizuar në nivelin 81%.
- Objektivit i përgjithshëm (mesatarja e 4 Objektivave Strategjike) për periudhën Dhjetor 2020-Shkurt 2021 rezulton të jetë 82.50%.

**5. Mbështetur në nivelin relativ të arritjes së çdo Objektivit Strategjik dhe Objektivit të Përgjithshëm, për periudhën progresive të raportimit Shtator 2021-Dhjetor 2021 rezulton se:**

- Objektivit Strategjik nr. 1 është realizuar në nivelin 85%.
- Objektivit Strategjik nr. 2 është realizuar në nivelin 77%.



- Objektivi Strategjik nr. 3 është realizuar në nivelin 100%.
- Objektivi Strategjik nr. 4 është realizuar në nivelin 97%.
- Objektivi i Përgjithshëm (mesatarja e 4 Objektivave Strategjike) për periudhën Dhjetor 2020-Shkurt 2021 rezulton të jetë 89.75%.

Mbështetur në analizën e shkallëzuar të realizimit të aktiviteteve, për periudhën e raportimit Dhjetor 2022-Dhjetor 2021, shpërndarja e aktiviteteve sipas nivelit të realizimit të objektivit paraqitet si vijon:

- Me nivelin e realizimit deri në 90% - 100% paraqiten 30 aktivitete;
- Me nivelin e realizimit deri në 80% paraqiten 2 aktivitete;
- Me nivelin e realizimit deri në 70% paraqiten 2 aktivitete;
- Me nivelin e realizimit deri në 50% paraqiten 4 aktivitete;
- Me nivelin e realizimit deri në 30% paraqiten 0 aktivitete;
- Me nivelin e realizimit deri në 20% paraqiten 1 aktivitet;
- Me nivelin e realizimit deri në 10% paraqiten 1 aktivitet;
- Aktivitete të përealizuara 0% paraqiten 4 aktivitete.

Mbështetur në analizën e aktiviteteve dhe % të realizimit të tyre, është konstatuar se **7 aktivitete** janë në nivele të ulta dhe duhet të prioritizohen në vijimësi, pasi indikatorët e tyre janë në nivel shumë të ulët, ose zero.

- Objektivi Strategjik nr. 1, Objektivi Specifik 1. 1, ka gjithsej 6 aktivitete/masa, nga të cilat 3 aktivitete rezultojnë në nivele të ulta ose zero.
- Objektivi Strategjik nr. 1, Objektivi Specifik 1. 3, ka gjithsej 4 aktivitete/masa, nga të cilat 1 aktivitet rezulton në nivele të ulta.
- Objektivi Strategjik nr. 2, Objektivi Specifik 2. 2, ka gjithsej 2 aktivitete/masa, nga të cilat të dyja aktivitetet rezultojnë në nivele të ulta ose zero.
- Objektivi Strategjik nr. 2, Objektivi Specifik 2. 4, ka gjithsej dy aktivitete/masa, nga të cilat 1 aktivitet rezulton në nivel të ulët ose zero.

Konkretisht:

- Tek Objektivi Strategjik 1; “Fuqizimi dhe ushtrimi i veprimtarisë së ILD-së në mënyrë të pavarur, efiçente dhe profesionale”, Objektivi Specifik 1. 1, “Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e funksioneve nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet sigurimit të hapësirave, mjediseve, pajisjeve dhe kushteve të punës”, aktiviteti 2, “Rikonstruksioni i ambienteve të brendshme për pajisjen me ambiente pune për të gjithë numrin e punonjësve sipas strukturës dhe organikës së miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 28/2020”, është **realizuar në nivelin 3. 57%**.
- Tek Objektivi Strategjik 1; “Fuqizimi dhe ushtrimi i veprimtarisë së ILD-së në mënyrë të pavarur, efiçente dhe profesionale”, Objektivi Specifik 1. 1, “Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme për

ushtrimin e funksioneve nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet sigurimit të hapësirave mjediseve, pajisjeve dhe kushteve të punës”, aktiviteti 3, “Sigurimi i ambienteve të posaçme me standardet teknike për pajisjet e zhvillimit të teknologjisë së informacionit (dhomë e pavarur serveri), në përputhje me standardet Evropiane”, është **realizuar në nivelin 0%**.

- Tek Objektivi Strategjik 1; “Fuqizimi dhe ushtrimi i veprimtarisë së ILD-së në mënyrë të pavarur, efëiente dhe profesionale”, Objektivi Specifik 1. 1, “Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e funksioneve nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet sigurimit të hapësirave, mjediseve, pajisjeve dhe kushteve të punës”, aktiviteti 4, “Zhvillimi i sistemit për lidhjen me rrjetin “Portën Qeveritare” që mundëson hyrjen në sistemet IT të institucioneve të drejtësisë, KLGJ/KLP të nevojshme për punën e ILD”, është **realizuar në nivelin 0%**.
- Tek Objektivi Strategjik 1; “Fuqizimi dhe ushtrimi i veprimtarisë së ILD-së në mënyrë të pavarur, efëiente dhe profesionale”, Objektivi Specifik 1. 3, “Përmirësimi i menaxhimit dhe komunikimit të brendshëm organizativ të administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, aktiviteti 4, “Hartimi i rregullores së roleve dhe përdorimit të sistemit”, është **realizuar në nivelin 20%**.
- Tek Objektivi Strategjik 2; “Zhvillimi i procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit në përputhje me parimet e procedimit disiplinor dhe standardet ndërkombëtare”, Objektivi Specifik 2. 2 “Standardizimi/unifikimi i metodave dhe proceseve të punës për trajtimin e ankesave apo zhvillimin e veprimtarisë inspektuese dhe hetimore”, aktiviteti 1, “Hartimi i rregullores për trajtimin e ankesave”, është **realizuar në nivelin 0%**.
- Tek Objektivi Strategjik 2; “Zhvillimi i procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit në përputhje me parimet e procedimit disiplinor dhe standardet ndërkombëtare”, Objektivi Specifik 2. 2, “Standardizimi/unifikimi i metodave dhe proceseve të punës për trajtimin e ankesave apo zhvillimin e veprimtarisë inspektuese dhe hetimore”, aktiviteti 2, “Hartimi i metodologjisë për inspektim”, është **realizuar në nivelin 0%**.
- Tek Objektivi Strategjik 2; “Zhvillimi i procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit në përputhje me parimet e procedimit disiplinor dhe standardet ndërkombëtare”, Objektivi Specifik 2. 4, “Rritja e numrit të ankesave të trajtuara në përputhje me afatet ligjore”, aktiviteti 3, “Shqyrtimi me prioritet i ankesave sipas gjetjeve të grupeve të punës për evidentimin dhe kategorizimin e ankesave të bartura nga institucionet e tjera, sipas objektit”, është **realizuar në nivelin 20%**.

- ❖ Mbështetur në analizën dinamike të realizimit të indikatorëve të Strategjisë, trendi i realizimit ka ardhur në rritje për secilin nga komponentët e Objektivave Specifikë, më përjashtim të Objektivit Strategjik 2, i cili mbetet i pandryshueshëm për periudhat e raportimit Qershor-Gusht 2021; Shtator-Dhjetor 2021 dhe Objektivit Strategjik 4, i cili mbetet i pandryshueshëm për periudhat e raportimit Mars-Maj 2021 dhe Qershor-Gusht 2021. Konkretisht:

Nr.	OBJEKTIVI STRATEGJIK (OS)	REALIZIMI PERIODIK			
		Dhjetor 2020-Shkurt 2021	Mars-Maj 2021	Qershor-Gusht 2021	Shtator-Dhjetor 2021
1.	OS 1	61%	68%	71%	85%
2.	OS 2	66%	74%	77%	77%
3.	OS 3	100%	100%	100%	100%
4.	OS 4	72%	81%	81%	97%
	Realizim i Planit Strategjik.	74.75%	80.75%	82.50%	89.75%
	<b>Realizimi vjetor i Planit Strategjik.</b>			<b>81.9%</b>	

Rezulton se, deri më datë 31.12.2021, afërsisht **68.18 %** e aktiviteteve janë realizuar në nivelin 100%, afro 22.72% e aktiviteteve të tjera janë realizuar pjesërisht dhe vijojnë duke u ndjekur, ndërsa 9.09% e aktiviteteve rezultojnë të porealizuara.

## KREU V - BURIMET FINANCIARE

Procesi i kostimit të Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është bazuar në konsultimin e dokumenteve kombëtare, përfshirë këtu ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, Programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2021-2023, si dhe konsultimet me aktorët e përfshirë në hartimin e këtij plani strategjik.

Është synuar që nëpërmjet këtij procesi të evitohen mbivendosjet financiare në dokumentet e tjerë

strategjike, si dhe plani i veprimit është shoqëruar me një kostim analitik të secilës masë.

Shpërndarja e burimeve financiare që financojnë aktivitetet e Planit të Veprimit për secilin Objektiv Strategjik dhe Objektiv Specifik dhe aktivitetet për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2021 është 86 milion e 347 e mijë lekë.

## **KREU VI - KONKLUSIONE**

Viti 2021, ka qenë një vit pune me ngarkesë të theksuar për shkak të mungesave në kapaciteteve njerëzore e infrastrukturore, por në sajë të objektivave të vendosura dhe të matshme, janë arritur prioritetet kryesore, pasi nga 44 aktivitete që përmban Plani i Veprimit dhe Plani Strategjik i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë realizuar plotësisht 30 prej tyre.

Për vitin 2022, lind nevoja e nxitjes dhe ndërgjegjësimit se prioritet i punës për vitin vijues të Planit Strategjik, duhet të jenë ato aktivitete/masa të cilat janë në nivele të ulta ose zero.

Këtu mund të përmendim:

- Përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së përgjithshme dhe në veçanti, asaj verifikuese dhe inspektuese, me fokus të veçantë zhvillimit teknologjik të një sistemi të konsoliduar të menaxhimit të çështjeve.
- Shqyrtimi me prioritet i ankesave sipas gjetjeve të grupeve të punës për evidentimin dhe kategorizimin e ankesave të bartura nga institucionet e tjera, sipas objektit.
- Zhvillimi i sistemit për lidhjen me rrjetin “Portën Qeveritare” që mundëson hyrjen në sistemet IT të institucioneve të drejtësisë, KLGJ/KLP të nevojshme për punën e ILD.
- Hartimi për inspektim metodologjie të përgjithshme mbi mënyrën e realizimit të një inspektimi institucional apo tematik.

Nga monitorimi rezulton se për vitin në vijim, njësitë përgjegjëse për përcjelljen e informacionit mbi nivelin e zbatimit të secilit aktivitet, duhet të reagojnë brenda afateve të vendosura dhe të kërkojnë në çdo moment asistencë në plotësimin e rubrikave të paracaktuara në formatin e raportimit.

Për shkak të strukturës organizative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, një pjesë e njërive raportues nuk kanë drejtues, ndaj grumbullimi i informacionit, vjen nga një punonjës, i cili raporton për njësinë. Kjo mënyrë është efiçente për atë kohë sa informacioni vjen pranë njësisë së raportimit, por nuk garanton cilësinë dhe saktësinë e informacionit. Për këtë qëllim është parë e nevojshme ngritja e një mekanizimi që do të shqyrtojë të dhënat dhe problematikën e hasura në gjenerimin e të dhënave.

Redaktoi: A. Laze  
Datë 28.07.2022

